



Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI E SPORT

PLANI I PUNËS PËR VITIN 2011

Vushtrri, Dhjetor 21, 2010

**Drejtori i DKRS
Qamil Sahiti**

Në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport janë këta sektor:

1. Sektori për Kulturë

- Qendra e Kulturës “ Hasan Prishtina “ – Vushtri,
 - Ansambli i Këngëve dhe Valleve,
 - Teatri
- Shtëpia e Kulturës “ Ramadan Fazliu “ – Shtruterë,
- Biblioteka,
- Arkiva,
- Muzeu.

2. Sektori për Rini

3. Sektori për Sport

- Klubet dhe Shoqatat Sportive,
- Objektet Sportive.

Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport, parasheh një plan të ngjeshur të punës për vitin 2011 në të gjithë sektorët.

Në Qendrën e Kulturës “ Hasan Prishtina “ do të ketë një angazhim shtesë në mirëmbajtje të objektit dhe hapësirës respektivisht kopshtit të saj. Angazhimi shtesë nënkupton angazhimin e të gjithë stafit për një pastrim dhe sistemim të të gjitha hapësirave të brendshme dhe materialeve e mjeteve të punës. Rregullimin e të gjitha hapësirave në mënyrë më të përshtatshme për funksionim normal dhe efikas të detyrave të përditshme dhe aktiviteteve. Rëndësi të veçantë do t`i ipet sanitimit të dëmtimeve në sallën e madhe sidomos të ulëseve. Kopshti para dhe pas Qendrës së Kulturës do të mirëmbahet rregullisht me bari të freskët dhe lule në mënyrë që të jep një pamje me mozaik ngjyrash qendrës së qytetit.

Në aspektin profesional të zhvillimit të kulturës do të organizohen aktivitete të ndryshme si:

- Organizimi i të gjitha festave shtetërore e kombëtare,
 - Harmonizimi i përgatitjeve me Drejtoritë Komunale,
 - Përgatitja e hapësirës dhe skenografisë,
 - Përgatitja e skenarit,
 - Përgatitja dhe realizimi komplet i programit artistik,etj.
- Shënimi i të gjitha datave përkujtimore,
- Përgatitjet e vazhdueshme ditore artistike,
- Organizimi i manifestimit “ Takimet e Poeteshave “,
- Organizimi i Festivalit Komunal të Këngës për Fëmijë,
- Organizimi për “ Ditët e Hasan Prishtinës “, etj.

Ansambl i Këngëve dhe Valleve “ Hasan Prishtina “ do të vazhdojë me përgatitjet e përditshme në mënyrë që të jetë i gatshëm në çdo kohë për performancë. Do të krijohen mundësi të reja për angazhim më të madh të të rinjve dhe profesionistëve në aktivitetin e ansamblit.

Teatri i Qytetit do të angazhohet për përgatitjen e shfaqjeve, skeqeve dhe inkorporim në programet e ndryshme gjatë vitit si moderator, interpretues dhe inskenim mbështetës të pamjeve të ndryshme artistike. Gjithashtu do të bëhet një angazhim shtesë për dhënien e mundësisë për angazhim të aktorëve të rinj. Do të lidhen marrëveshje me teatro të qyteteve të tjera për të dhënë shfaqje në Vushtrri.

Shtëpia e Kulturës “ Ramadan Fazliu “ në Shtruderë, ka nevojë për një restaurim të vogël dhe angazhim respektivisht punësim të ndonjë përgjegjësi për menagjim të aktiviteteve. Në këtë drejtim do të angazhohemi që të krijohen kushte për vazhdimin e aktivitetit të Shoqërisë Kulturore Artistike “ Bahri Kuqi “ dhe degës së bibliotekës.

Biblioteka “ Naim Frashëri “ ka një fond jo të mjaftueshëm të librave, sidomos atyre shkollore e shkencore. Do të pasurohet ky fond i librave me anë të investimit dhe bashkëpunimit me qendrat e tjera bibliotekare të Kosovës.

Gjatë vitit 2011 do të organizohen takime me nxënës dhe qytetar që për qëllim do të kenë afrimin me lexuesin dhe nxitjen për sjelljen e investimeve në pasurimin e fondit të librit.

Gjithashtu biblioteka do të organizojë aktivitete të ndryshme si:

- Ekspozita me poezi për fëmijë,
- Ekspozita me punimet letrare,
- Garat në poezi për fëmijë, etj.

Me renovimin e objektit të ish-TMK-sw do të krijohen kushte të reja për **Arkivin Historik Komunal**. Arkivi do të bartet në këtë objekt dhe do të ketë hapësirë të mjaftueshme për zhvillimin e mëtytjeshëm të këtij sektori. Në vitin 2011, arkivi do të pajiset me mjetet e nevojshme elektronike për fillimin e regjistrimit dhe digjitalizimit të arkivës.

Gjithashtu edhe **Muzeu Etnografik** do të bartet në objektin e rinovuar qw pritet tw pwrfundojw gjatw vitit 2011. Në këtë mënyrë do të krijohen mundësi të reja për zhvillimin e aktivitetit të Muzeut. Përveq hulumtimeve të ndryshme në komunën tonë, do të krijohet edhe mundësia e hapjes së ekspozitave me ekspozate të gjetura. Muzeu do të ketë hapësirë të përshtatshme për ruajtje dhe studim të ekspozateve. Me krijimin e hapësirës së nevojshme, do të shtohet aktiviteti i Muzeut në të gjitha fushat përkatëse dhe do të kemi një ndër Muzetë më të mirë në Kosovë.

Sektori i Rinisë do të jetë sektori që në vitin 2011 do të jetë një ndër sektorët më aktiv në Drejtorinë për Kulturë, Rini e Sport.

Në këtë sektor parashihet një numër i madh i aktiviteteve rinore në qytet e fshat. Krijimi i kushteve për angazhim të rinisë është objektiv i këtij sektori. Fillimisht me plan parashihen debate e tryeza për tema që kanë të bëjnë me rininë. Më pas investimi në aktivitete rinore në të mirë të rinisë dhe gjithë popullatës siq janë aktivitete për vetëdijësim, aktivitete kulturore e sportive, etj.

Do të fillojë investimi në bashkësi lokale për zhvillimin e aktiviteteve të lira rinore sidomos atyre sportive me shuma të vogla në fusha basketbolli dhe volejbolli.

Në mënyrë të veçantë do të bëhet organizimi i Muajit të Rinisë që do të shënohet me aktivitete të larmishme.

Në **Sektorin e Sportit** do të bëhet një angazhim më i madh në krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e gjithanshëm. Do të përfundojë projekti në bashkëpunim me Ministrinë për Kulturë, Rini e Sport për renovimin e kulmit të Palestrës Sportive “Jeton Terstena “. Shfrytëzimi i kësaj palestere me klubet sportive do të rregullohet me një propozim të ri në Kuvendin Komunal që do të hartohet nga Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport.

Gjithashtu edhe aktivizimi i hapësirave të ndryshme për shfrytëzim nga klubet dhe shoqatat sportive është objektiv i vitit 2011.

Përkrahja dhe organizimi i ngjarjeve të ndryshme sportive në bashkëpunim me të gjithë faktorët relevant.

Do të bëhet një kategorizim, në bazë të kriterëve të përcaktuara, për mbështetjen, respektivisht propozimin për subvencionimin e klubeve sportive.

Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport do të vazhdojë me intensitet të shtuar punën për investim në hulumtim arkeologjik, arkitektural, studim historik, restaurim, konservim dhe investim për funksionalizimin e monumenteve historike e kulturore. Natyrisht që kjo do të bëhet në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sportit dhe Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës dhe të gjithë faktorët tjerë relevant. Në këtë mënyrë do të krijohen mundësi të reja jo vetëm për popullatën e komunës së Vushtrrisë por edhe më gjerë për tu njohur me ciklin e civilizimit njerëzor në këto hapësira.

Në vitin 2011 do të rregullohet hapësira e Galerisë së Qytetit. Kjo hapësirë do të meremetohet në objektin e Muzeut.

Synim i yni mbetet restaurimi i Qendrës së Kulturës “Hasan Prishtina”, në mënyrë që të krijohen mundësi më të mëdha për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, por edhe të jipet një pamje më e mirë e qendrës së qytetit.

Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport do të zhvillohet edhe më tej edhe me angazhimin e bashkëpunëtorëve dhe këshilltarëve të jashtëm profesional të dëshmuar në gjith komb.

Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport do të jetë e gatshme të jap kontributin e saj në çdo kohë në të gjitha projektet komunale e shtetërore.

Drejtori i DKRS
Qamil Sahiti

21.12.2010